



RREGULLORJA NR. 2004/50

MBI THEMELIMIN E MINISTRIVE TË REJA DHE KRIJIMIN E POSTEVE TË ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE TË ZËVENDËSMINISTRAVE NË DEGËN E EKZEKUTIVIT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në përputhje me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi themelimin e degës së ekzekutivit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje në Kosovë dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/5 të datës 4 mars 2002 me të cilën u ndryshua Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19,

Me qëllim të plotësimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 deri në përfundimin e ndryshimeve të saj përmes krijimit të ministrive të reja dhe krijimit të postit të zëvendëskryeministrit dhe të posteve të zëvendësministrave në degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes,

Me anë të kësaj shpall:

Neni 1 Ministritë e reja

- 1.1 Në degën e ekzekutivit të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes krijohen këto ministri të reja:

(a) Ministria për Komunitete dhe Kthime. Kjo ministri është përgjegjëse për çështje që ndërlidhen me mbështetjen dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, duke përfshirë të drejtën për t'u kthyer, si dhe lehtësimin dhe bashkërendimin e zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve dhe strategjive të ngjashme;

(b) Ministria për Energjetikë dhe Miniera. Kjo ministri ka përgjegjësi të përgjithshme për sektorin e energjetikës dhe për aktivitetet e ngjashme në veprimtarinë e minierave, për lehtësimin e zhvillimit dhe zbatimit të një strategjie koherente të energjetikës dhe minierave në Kosovë dhe

(c) Ministria për Administratën e Qeverisjes Lokale. Kjo ministri është përgjegjëse për çështjet që ndërlidhen me ngritjen e efektivitetit të vetëqeverisjes lokale. Në ushtrimin e kompetencave të veta për qeverisje lokale efektive, ministria është përgjegjëse për të siguruar ofrimin e shërbimeve publike të kontrolluara nga niveli qendror për plotësimin e nevojave të të gjitha komuniteteve dhe sigurimin e qasjes së barabartë në shërbimet e tilla.

1.2 Përgjegjësitë e detajuara dhe funksionimi i ministrive nga neni 1.1 do të përcaktohen në një rregullore të mëvonshme me të cilën do të ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19. Ministrinë i marrin kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse pas hyrjes në fuqi të Rregullores me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19. Deri atëherë kompetencat dhe përgjegjësitë në fjalë vazhdojnë të ushtrohen nga autoritetet dhe subjektet që aktualisht kanë përgjegjësi për kryerjen e tyre.

Neni 2

Zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat

2.1 Në kuadër të degës së ekzekutivit mund të krijohen poste të zëvendëskryeministrit dhe zëvendësministrave. Zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat emërohen nga Kryeministri pas miratimit të kandidatit në fjalë nga Kuvendi i Kosovës. Kandidatët për postet e tilla zgjedhen dhe i propozohen Kuvendit nga Kryeministri, pas konsultimeve në nivel politik dhe në bashkërendim me PSSP-në. Zgjedhja e kandidatëve bëhet në mënyrë të përshtatshme duke marrë parasysh kërkesën për sigurimin e përfaqësimit të barabartë të serbëve të Kosovës dhe të komuniteteve të tjera pakicë. Funksionet dhe përgjegjësitë e zëvendëskryeministrit dhe zëvendësministrit përcaktohen nga Kryeministri, përkatësisht nga ministri në fjalë, me miratimin e Qeverisë.

2.2 Nëse posti i Kryeministrit përkohësisht është i lirë, zëvendëskryeministri ushtron funksionin e Kryeministrit.

2.3 Nëse një ministër përkohësisht nuk është në gjendje të kryejë detyrat e tij, funksionet e ministrisë ushtrohen nga zëvendësministri ose, nëse nuk ka zëvendësministër, nga një zyrtar i lartë i ministrisë i caktuar nga ministri.

Neni 3
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në harmoni me të.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 2 dhjetor 2004.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm